



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni Pranvrer

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 05/2010

Prishtinë më 05. 02. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Zef Morina dhe Qamile Morina

Munguan: Slobodan Petroviq, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala, Nerxhivane Dauti, dhe Myfera Sinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Ramaj – KDI, Haxhi Gashi - USAID, Siv - K Weirtrove dhe Besim Zeqiri - ICO, Lumnije Murati - ZPRK, Agron Demi - GAP dhe Saranda Stublla-Lëvizja “FOL”.

Nga Zyra Mbështetës e Komisionit: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Raportimi i ministrit të MTPT- së për situatën aktuale lidhur me Projektin e autoudhës Morinë - Merdar.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

I. Raportimi i ministrit të MTPT- së për situatën aktuale lidhur me Projektin e Autoudhës Morinë-Merdar

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit së kishin ardhur përfaqësuesit (këshilltarët e ministrit Limaj) nga Ministria e Transportit dhe e Post-Telekomunikacionit (tutje Ministria). Konstatoi se Komisioni, ftesën ia kishte dërguar ministrit Limaj ose zëvendësministrit të Ministrisë. Në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit ka të drejtë t'u raportojë deputetëve vetëm ministri ose zëvendësministri dhe kërkoi nga këshilltari i ministrit, z. Ilhami Gashi, ta lironte sallën.

Ilhami Gashi - këshilltari i ministrit Limaj – Theksoi se kishte ardhur ta konfirmonte mospraninë e ministrit Limaj për shkaqe të agjendës së ngjeshur. Njëherësh njoftoi se ministri nuk mund të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit para datës 16 shkurt 2010.

Fatmir Rexhepi - Tha se ne, si Komision, e kemi ngritur këtë çështje që ta kemi një debat në kuadër të një informate dhe të shohim se çka është duke punuar Qeveria dhe Ministria përkatëse rreth Projektit të rëndësishëm të Autoudhës Morinë-Merdar. Shtoi se mosardhjen e ministrit për raportim në Komision e vlerëson si një sabotim dhe mungesë transparence për ta përmyllur Projektin, që e dëmton imazhin e vendit. Lidhur me nismat për ndryshimin trasesë se Autoudhës, i paraqiti disa arsyeje, pse nuk pajtohet, që të këtë devijim nga Projekti kryesor, me modelin e financimit që e ka propozuar Qeveria dhe Ministria përkatëse për kompaninë që e ndërton Autoudhën. Propozoi që Komisioni ta ftojë ministrin e MTPT-së, z. Limaj, në interpelancë, për hir të rëndësisë që ka ky projekt i madh për vendin.

Kryetarja – Kërkoi nga Njësia Mbështetëse e Komisionit këshilla ligjore, se a ka të drejtë Komisioni ta ftojë në interpelancë një ministër për një çështje të caktuar.

Hasan Tahiri - koordinator i Njesisë për Mbështetje të Komisionit – Tha se duke u bazuar në rregullën 25 të Rregullores së punës së Kuvendit, interpelancë mund të parashtrijë vetëm grupi parlamentar e jo Komisioni.

Zef Morina - Theksoi se në një debate në TV, më ministrin Limaj, e kishte kuptuar se nuk është duke u ndryshuar traseja, por janë në negociata. Sa i përket devijimit, ministri Limaj ka pohuar, se ende nuk është marr vendim. Ai beson se do të përfshihen të gjitha

arteriet kryesore, duke i përfshirë Qeverinë dhe Kuvendin. Duke e specifikuar Projektin tha se sa i përket Gjilanit ka qene dhe është paraparë që ajo pjesë, ta ketë autoudhën e vet, të lidhet me korridorin që shkon Prishtinë – Shkup. Mirëpo shqetësohet se në qofte së behët ky devijim, mos po ngelin pa u lidhur me korridoret ndërkombëtare.

Ethem Çeku – Theksoi së në marrëdhëniet Qeveri - Kuvend, po shihet se ka vështirësi të komunikimit zyrtar. Një pjese të debatit po paraqitet nëpër media. Do të kishte qenë mirë që debati të zhvillohej në Komisionin Parlamentar, që është Komision FunkSIONAL për mbikëqyrjen e MTPT-së, dhe ta bëjë këtë debate këtu që të informohemi zyrtarisht. Papërgjegjësia e Ministrisë që ta kemi një material të shkruar, për informacionin rreth punëve të Autoudhës është shqetësuese. Problemi i dytë sipas tij qëndron në mosardhjen e ministrit ose të zëvendësministrit, që të informojnë për punën lidhur me Autoudhën. Propozoi, që të diskutohet përsëri në mbledhjen e radhës.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Për shkak të mungesës së kuorumit, kjo pikë e rendit të ditës mbetet të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani